V E N D I M
Nr. 81 datë 6.2.1995

PËR RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përbërja e Këshillit të Ministrave

1.1. Anëtarë të Këshillit të Ministrave janë: Kryetari, zëvendëskryetarët, ministrat dhe persona të tjerë të barazuar me ta.

1.2. Kryetari i Këshillit të Ministrave përfaqëson Këshillin e Ministrave, kryeson mbledhjet e tij, drejton veprimtarinë e tij të përgjithshme dhe përgjigjet për të, si dhe bashkërendon punët e ministrive dhe të instuticioneve të tjera qendrore.

1.3. Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, në mungesë të Kryetarit dhe me autorizimin e tij, kryeson mbledhjet e Këshillit të Ministrave.

1.4. Ministrat dhe personat e tjerë të barazuar me ta janë anëtarë të Këshillit të Ministrave, drejtojnë ministritë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse në degë të caktuara veprimtarie dhe përgjigjen para Këshillit të Ministrave për veprimtarinë e ministrive e të institucioneve të tjera qendrore që u janë besuar të drejtojnë.

2. Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

2.1. Mbledhjet e Këshillit të Ministrave zhvillohen, si rregull, një herë në javë, sipas njoftimit të rendit të ditës.

Mbledhje mund të zhvillohen edhe në kohë tjetër, kurdoherë që Kryetari i Këshillit të Ministrave e shikon të arsyeshme.

2.2. Në mbledhjet e Këshillit të Ministrave marrin pjesë vetëm anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe për projekte që mund të kërkohen shpjegime teknike, përjashtimisht, me miratim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, mund të ftohen për pika të veçanta ekspertë nga ministritë përkatëse.

2.3. Me miratim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, në mungesë të anëtarëve, në mbledhjet e Këshillit të Ministrave marrin pjesë zëvendësministrat pa të drejtë vote.

Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave marrin pjesë pa të drejtë vote edhe sekretarët e shtetit, kurdoherë që ftohen nga Kryetari.

3. Rendi i ditës i mbledhjeve të Këshillit të Ministrave

3.1. Rendi i ditës i mbledhjeve të Këshillit të Ministrave bazohet në projektet e problemet e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe përgatitet nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

3.2. Sekretari i përgjithshëm, për përgatitjen e rendit të ditës së mbledhjes, konsultohet me Kryetarin e Këshillit të Ministrave.

3.3. Rendi i ditës i mbledhjes, së bashku me materialet përkatëse me shënimin "personale", i dërgohet me korrier nga sekretari i përgjithshëm çdo anëtari të Këshillit të Ministrave. Materialet duhet të arrijnë në destinacion jo më pak se tri ditë pune para mbledhjes së ardhshme të Këshillit të Ministrave.

3.4. Rendi i ditës i mbledhjeve përbëhet nga tri pjesë:

- Pjesa e parë ka të bëjë me projektligjet, projektdekretet dhe projektet e akteve të Këshillit të Ministrave, për të cilat janë shprehur dakord ministrat e interesuar dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave.

- Pjesa e dytë me projektet me karakter urgjent, sipas vlerësimit të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe projektet, për të cilat nuk është arritur konsensus nga ministritë e interesuara në komitetin ndërministror përkatës, por që Kryetari i Këshillit të Ministrave çmon se për to duhet të gjykojë dhe të vendosë Këshilli i Ministrave.

- Pjesa e tretë ka të bëjë me raportime, informacione dhe probleme të tjera të përgjithshme të anëtarëve të Këshillit të Ministrave, që kanë marrë miratimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

4. Marrja e vendimeve

4.1. Vendimet e Këshillit të Ministrave merren kur miratohen nga shumica e anëtarëve të tij.

4.2. Projektet që shqyrtohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave mund të miratohen, ndryshohen, të shtyhen për shqyrtim të mëvonshëm ose të kthehen për bashkërendim me ministritë e interesuara. Projektet mund të tërhiqen nga propozuesit e tyre.

5. Raporti përfundimtar, njoftimi dhe komunikata për masmedian

5.1. Pas çdo mbledhjeje të Këshillit të Ministrave hartohet nga sekretari i përgjithshëm një raport përfundimtar për mbledhjen dhe një njoftim për ministritë.

5.2. Raporti përfundimtar përmban pjesëmarrjen në mbledhje, rendin e ditës së mbledhjes, konkluzionet përkatëse për çdo projekt të shqyrtuar, shënimin për miratimin pa ndryshime të tekstit të projektit ose për miratimin me ndryshime të këtij teksti, duke evidencuar qartë ndryshimet, shënimin për refuzimin, shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm ose kthimin mbrapsht të projekteve të shqyrtuara për bashkërendim më të mirë ndërmjet ministrive të interesuara.

Në raport përfshihen edhe problemet e përgjithshme të diskutuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe detyrat për ndjekjen e tyre.

5.3. Raporti përpilohet në tri kopje, njëra prej të cilave mbahet në zyrën e Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe tjetra në zyrën e sekretarit të përgjithshëm. Kopja e tretë bashkohet me rendin e ditës së mbledhjes të Këshillit të Ministrave, projektet origjinale të shqyrtuara, raportet dhe informacionet e paraqitura dhe arkivohen.

5.4. Njoftimi për ministritë përgatitet dhe shpërndahet nga sekretari i përgjithshëm brenda ditës së mbledhjes së Këshillit të Ministrave.

Njoftimi përmban shënimin për çdo projekt të shqyrtuar, miratuar pa ndryshime, miratuar me ndryshime për t'u përpunuar nga ministria propozuese dhe i pamiratuar.

5.5. Pas çdo mbledhjeje të Këshillit të Ministrave përgatitet komunikata nga kabineti i Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe i dërgohet masmedias. Kjo komunikatë përmban projektet e shqyrtuara e të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe një përmbledhje të përmbajtjes së tyre.

6. Nënshkrimi i akteve

6.1. Sekretari i përgjithshëm drejton procesin e nënshkrimit të akteve të Këshillit të Ministrave dhe shpërndarjen e tyre. Ato siglohen nga ministri propozues dhe sekretari i përgjithshëm dhe nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Sekretari i përgjithshëm drejton procesin e përgatitjes e të nënshkrimit të projektligjeve e projektdekreteve të shqyrtuara e miratuara në Këshillin e Ministrave dhe dërgimit të tyre përkatësisht Kuvendit Popullor ose Presidentit të Republikës. Ato siglohen nga ministri propozues e sekretari i përgjithshëm dhe nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Sekretari i përgjithshëm drejton procesin e kundërfirmimit nga Kryetari i Këshillit të Ministrave të dekreteve të Presidentit të Republikës. Para kundërfirmimit, Kryetari i Këshillit të Ministrave vendos nëse dekreti duhet ose jo të shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

6.2. Sekretari i përgjithshëm , në bashkëpunim me ministrinë propozuese, drejton procesin e përgatitjes përfundimtare para nënshkrimit të akteve të Këshillit të Ministrave të miratuara me ndryshime në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

7. Besueshmëria dhe solidarësia

7.1. Rendi i ditës i mbledhjes, vlerësimet, debatet, vendimet dhe raportimet përfundimtare të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave janë konfindenciale.

7.2. Në mbledhjet e Këshillit të Ministrave nuk mbahen procesverbale dhe nuk bëhen incizime magnetofonike dhe stenografime.

7.3. Nëpunësit që punojnë në aparatin e Këshillit të Ministrave dhe të ministrive duhet të parandalojnë shpërndarjen dhe diskutimin e projekteve që janë në shqyrtim ose që do të shqyrtohen nga Këshilli i Ministrave.

7.4. Anëtarët e Këshillit të Ministrave duhet t'i respektojnë vendimet e marra në mbledhjet e Këshillit të Ministrave. Në mënyrë të veçantë ata duhet të mënjanojnë çdo shprehje mospajtimi, të mbrojnë ose të përkrahin vendimet e lartëpërmendura, pavarësisht nga fakti nëse kanë marrë pjesë në mbledhje apo jo dhe nëse kanë votuar pro ose kundër tyre.

7.5. Nëse një anëtar i Këshillit të Ministrave ose familja e tij ka interes material për çështje të veçanta që shqyrtohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, ai duhet të njoftojë Kryetarin e Këshillit të Ministrave para diskutimit të saj dhe nuk duhet as të marrë pjesë në diskutimin e çështjes, as të votojë për të dhe as të ndikojë në qëndrimin e anëtarëve të tjerë.

8. Komitetet ndërministrore

8.1. Komitetet ndërministrore janë organe konsultative të Këshillit të Ministrave, që synojnë koordinimin dhe përcaktimin e politikave qeveritare në fusha të rëndësishme të veprimtarisë shtetërore. Mbledhjet e komiteteve kryesohen nga Kryetari ose një anëtar i Këshillit të Ministrave i autorizuar nga Kryetari.

8.2. Komiteti i Politikës Ekonomike përbëhet nga ministri i Financave, ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, ministri i Burimeve Minerare dhe Energjetike, ministri i Industrisë, Transporit dhe Tregtisë, ministri i Ndërtimit e Turizmit dhe drejtori i Departamentit të Zhvillimimt dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj. Në mbledhjet e këtij komiteti ftohet të marrë pjesë edhe Governatori i Bankës së Shqipërisë .

Komiteti shqyrton çështje që kanë të bëjnë me hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikës ekonomike, hartimin e buxhetit dhe të reformës makroekonomike. Ai shqyrton propozime për projektligje e projektvendime të rëndësishme me efekte financiare.

8.3. Komiteti i Politikës Sociale përbëhet nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, ministri i Financave, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ministri i Arsimit, ministri i Kulturës, Rinisë e Sporteve, kryetari i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë dhe drejtori i Departamentit të Administratës Publike.

Komiteti shqyrton çështje që kanë të bëjnë me hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikës sociale, të punësimit, mbrojtjes shoqërore, sigurimit shoqëror e shëndetësor, të kualifikimit etj. Ai shqyrton propozime për projektligje e projektvendime të rëndësishme me efekte sociale.

8.4. Komiteti i Politikës së Sigurimit Kombëtar përbëhet nga ministri i Brendshëm, ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, ministri i Punëve të Jashtme dhe kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar. Në mbledhjet e këtij komiteti ftohet të marrë pjesë edhe Prokurori i Përgjithshëm.

Komiteti shqyrton çështje të rendit publik, të mbrojtjes, të politikës së jashtme dhe integrimit evropian, të koordinimit dhe harmonizimit të legjislacionit etj. Ai shqyrton propozime për projektligje e projektvendime të rëndësishme të sigurimit kombëtar.

8.5. Në mbledhjet e komiteteve ndërministrore, me miratim të kryesuesit të tyre, mund të marrin pjesë persona të tjerë sipas problematikave që shqyrtohen.

8.6. Komitetet ndërministrore i zhvillojnë mbledhjet sipas njoftimit të rendit të ditës të caktuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

8.7. Komiteti bën gjykimet, vlerësimet, vërejtjet dhe rekomandimet e tij për çështjet që shqyrtohen, në mënyrë që Këshilli i Ministrave të mbajë qëndrimin përfundimtar.

9. Grupet studimore të ekspertëve

9.1. Grupet studimore të ekspertëve ose këshilltarë të jashtëm caktohen nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, për të zgjidhur probleme të veçanta brenda një kohe të caktuar, me karakter studimor ekonomik, përgatitje aktesh të caktuara ligjore e nënligjore, studime sociale e administrative që do t'i shërbejnë Këshillit të Ministrave për realizimin e programit të tij.

9.2. Grupet përbëhen nga ekspertë të fushës për të cilën ngrihet grupi dhe zgjidhen nga administrata shtetërore, ekspertë të pavarur vendas a të huaj ose kompani konsultative.

9.3. Ekspertët e grupeve dhe këshilltarët e jashtëm, për punën që kryejnë, shpërblehen nga fondet e buxhetit të shtetit ose nga burime të tjera të asistencës së huaj me miratim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

10. Paraqitje e projekteve

10.1. Projektligjet, projektdekretet, projektet e akteve të Këshillit të Ministrave dhe materialet e tjera me karakter raportues, informues e të përgjithshëm i dërgohen me dy kopje me korrier aparatit të Këshillit të Ministrave në adresë të sekretarit të përgjithshëm.

10.2. Propozimet e projekteve bëhen vetëm nga anëtarët e Këshillit të Ministrave. Projektet e akteve që u përkasin institucioneve të tjera qendrore, paraqiten në Këshillin e Ministrave nëpërmjet anëtarëve të tij që mbulojnë degë të përafërta veprimtarie me këto institucione.

11. Përmbajtja e projekteve

11.1. Propozimet e projekteve duhet të përmbajnë: projektin, relacionin, mendimet ose vërejtjet e ministrive të interesuara dhe përmbledhjen që do të përfshihet në komunikatën e masmedias.

11.2. Relacionet që shoqërojnë projektet duhet të përmbajnë:

a) hyrjen, rëndësinë dhe motivin e projektit, të lidhura me problemet që trajton dhe objektivat

që do të arrihen;

b) lidhjen ose jo me programin e Këshillit të Ministrave;

c) përmbledhjen e përmbajtjes së projektit;

ç) harmonizimin me legjislacionin ekzistues;

d) analizat e hollësishme ekonomike financiare me efekte buxhetore të vitit në vazhdim dhe vitet pasardhëse, si dhe llogaritje të kostos shtesë buxhetore që mund të japë projekti;

dh) shpjegimin për mosmarrjen parasysh të vërejtjeve dhe mendimeve të ministrive të interesuara.

11.3. Vërejtjet dhe mendimet e ministrive të interesuara për projektet e propozuara duhet të jenë zyrtare dhe të nënshkruara nga drejtuesit e tyre.

12. Bashkërendimi i projekteve

12.1. Propozuesit e projekteve, në fazën parapërgatitore të akteve, mund t'u dërgojnë për mendim ministrive të interesuara objektin, qëllimin dhe strukturën, duke kërkuar edhe vlerësimin e tyre për projektin që do të propozojnë.

12.2. Propozuesit e projekteve, para se t'i paraqesin në aparatin e Këshillit të Ministrave, duhet t'i bashkërendojnë me të gjitha ministritë e interesuara.

12.3. Projektet me përmbajtje ekomomike dhe me efekte financiare duhet të bashkërendohen në çdo rast me Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, kurse projektet me përmbajte sociale, me efekte në burimet njerëzore dhe shpërblimet bashkërendohen me Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë dhe Departamentin e Administratës Publike.

12.4 Projektet e kodeve, të ligjeve e dekreteve, projektet e vendimeve e të urdhëresave të Këshillit të Ministrave duhet t'i dërgohen në çdo rast Ministrisë së Drejtësisë për të parë legjimitetin dhe për të shfaqur mendim për to.

12.5 Sekretari i përgjithshëm vendos kthimin e projekteve ministrive propozuese në rast se nuk plotësojnë kriteret dhe kushtet e këtij vendimi.

13. Mbledhjet paraprake

13.1 Për projektligjet, projektdekretet dhe projektet e akteve të Këshillit të Ministrave, të cilat nuk u janë kthyer ministrive propozuese sipas pikës 12.5, organizohen mbledhje paraprake nga kabineti i Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

13.2 Në mbledhjet paraprake marrin pjesë ekspertët e ministrave që kanë përgatitur projektin dhe të ministrive të tjera të interesuara që kanë dhënë mendime e vërejtje për projektet, ose mund të kontribuojnë për përmirësimin e tyre.

13.3 Projektet, për të cilat arrihet konsensus në mbledhjet paraprake se mund të shqyrtohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, përfshihen nga sekretari i përgjithshëm në pjesën e parë të rendit të ditës së mbledhjes.

Projektet, për të cilat arrihet konsensus se duhen ripunuar nga ministritë propozuese, u kthehen këtyre të fundit nga sekretari i përgjithshëm.

13.4. Projektet, për të cilat nuk arrihet konsensus në mbledhje paraprake, kabineti harton një informacion për kundërshtimet dhe komentet rreth tyre. Këtë informacion, së bashku me projektet, ia paraqet Kryetarit të Këshillit të Ministrave, i cili vendos për shqyrtimin e këtyre projekteve në mbledhje të komitetit përkatës ndërministror ose kthimin e tyre ministrive propozuese me vërejtjet dhe orientimet e rastit.

14. Programimi dhe raportimi

14.1. Anëtarët e Këshillit të Ministrave duhet të dërgojnë në kabinetin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave propozimet për programet analitike 3-mujore dhe vjetore të projekteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.

14.2. Mbi bazën e propozimeve të dërguara hartohen programet tremujore dhe vjetore të Këshillit të Ministrave, të koordinuara me programin e përgjithshëm të tij dhe programin ligjvënës të Kuvendit Popullor. Këto programe miratohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

14.3. Kryetari i Këshillit të Ministrave cakton një nga anëtarët e Këshillit të Ministrave për të koordinuar programin ligjvënës të Kuvendit Popullor me programin e Këshillit të Ministrave.

14.4. Anëtarët e Këshillit të Ministrave, në fund të çdo tremujori dhe viti, duhet t'i paraqesin Kryetarit të Këshillit të Ministrave raportet për efektet e krijuara nga zbatimi i akteve të miratuara për degët e caktuara të veprimtarisë që drejtojnë.

15. Botimi dhe shpërndarja e akteve

15.1. Sekretari i përgjithshëm përcakton aktet me karakter normativ që botohen në “Fletoren Zyrtare”, si dhe aktet e tjera që përfshihen në broshura e botime të tjera periodike, të cilat përgatiten nga aparati i Këshillit të Ministrave.

15.2. Shpërndarja zyrtare e akteve bëhet nën drejtimin e sekretarit të përgjithshëm brenda dy ditëve nga nënshkrimi i tyre.

16. Lidhjet me Kuvendin Popullor, Presidentin e Republikës dhe Gjykatën Kushtetuese

Projektligjet e paraqitura në Kuvendin Popullor, projekdekretet e paraqitura për miratim Presidentit të Republikës, si dhe ligjet, dekretet e aktet e Këshillit të Ministrave që gjykohen në Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe ligjet, mbrohen në emër të Këshillit të Ministrave nga anëtarët e tij që janë propozues të projekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi